VENDIM
Nr. 12, datë 14.1.2015

PËR RISHPËRNDARJE TË NUMRIT TË PUNONJËSVE, NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES DHE AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK, PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes pakësohet me 5 veta dhe bëhet, gjithsej, 8996 punonjës.

2. Numri i punonjësve të Agjencisë së Prokurimit Publik shtohet me 5 veta dhe bëhet 28 punonjës, ndërsa numri i përgjithshëm i punonjësve të institucioneve të tjera qeveritare bëhet 395 punonjës.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama